



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHËRBIMIVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
QENDRA SPITALORE RAJONALE BERAT
Njesia e Prokurimit

Nr. _____ prot.

Berat, më _____._____.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës –Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim me lënde ngrohese Pelet druri per sherbimin e ngrohjes”- Marrëveshje Kuadër me një operator te vetem ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë **14 (katermbedhjete) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.**

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 9,711,000 (nente milion e shtatqind e njembedhjete mije) Leke pa TVSH.

ne baze te kerkeses se miratuar me specifikimet teknike te Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse me Nr. 3748 Prot, datë 10.7.2025 per Furnizimin me lende ngrohese Pelet per sherbimin e ngrohjes me lende ngrohese Pelet druri për një periudhë te pritshme **14(katermbedhjete) muaj** , ne perllogaritjen e fondit limit me shkresen me Nr.4224 Prot, datë 04.08.2025

Burimi i Financimit : Me te ardhurat e Buxhetit te Shtetit.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): (09111400-4):Karburante te Drurit.

Forma juridike e finalizimit të procesit të prokurimit do të jetë; **Marrëveshje Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara.** Duke qënë se objekti i prokurimit është një mall që përdoret në mënyrë të përsëritur, i rëndësishëm, i cili do të zgjasë për një kohë të gjatë, dhe ka ndikim direkt në mbarëvajtjen e punës së AK. Të gjitha kushtet e kontratës do të jenë të përcaktuara ashtu si dhe cmimet e ofertës fituese dhe shërbimi do të kryhet bazuar në këto kushte e cmime. Sasitë do të jenë variabël nga kërkesat e AK së, duke mos tejkalluar vlerën dhe afatin e marrëveshjes kuadër.

Bazuar në nenin 39 të LPP-së i ndryshuar dhe në nenin 42 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor vendos te mos e ndajë procedurën e prokurimit ne lote per arsye sepse kjo garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e kryerjes se shërbimeve. Autoriteti/enti Kontraktor **Qendra Spitalore Rajonale Berat** ka

hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Spitalore Rajonale **Berat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit dhe kërkesat e pikës 1 (gërmat a / b) të kritereve të veçanta të kualifikimit janë parashikuar pa ndryshime, sipas formatit të dokumenteve standarde të tenderit të publikuara nga APP, dhe vendosja e tyre është bazuar në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; 194,220 (njqind e nentedhjete e kater mije e dyqind e njezete).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP të ndyshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndyshuar, në të cilin është e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë e kriterëve plotësohet me kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit të plotësuar më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, “Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila parashikon se Autoriteti Kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 (të paraqitura ne organet tatimore dhe te konfirmuara nga ana e ketyre organeve). Kjo kerkese konsiderohet e permbushur kur bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 *Deshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më të vogël se 30%** të vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe **sasite e mallrave të realizuara**.

ose

B) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **sasite e mallrave të realizuara**.

Shenim: Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen e nevojave të AK.

Shenim: Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vetdeklarojë përmbushjen e specifikimeve për pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës si më poshtë. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, si më poshtë:

Specifikimet teknike të pajisjeve teknike, si më poshtë:

I. 1 (një) djegës (brucator) me pelet me këto karakteristika;

-fuqia min/max në kë	400-500KW
-tensioni i punës	220 v -240 v
-fuqia e motorit të ventilatorit	190w
-kandela e ndezjes	750w
-Dimensionet	360x420x1200mm
-Shneku	$\Phi 110mm$
-fuqia motorit të shnekut	180w
-dimensioni i tubit të shkarkimit	75 mm
- pesha	80 -100 kg

II. 1 (një) kaldajë me Pelet, me fuqi 480-500 kw me keto karakteristika;

-tensioni i punes	380V- 400V
- fuqia motorike	1100W
- rendimenti	55%-87%
-presioni i ujit	1.5-3.8 bar
-lartësia x gjatësia x gjerësia	2750x2180x1720 mm
-pesha	1750 – 1900 kg
-kapaciteti ditor i sillozit	1.5m3-2m3

III. 1 (një) kaldajë me Pelet, me fuqi 220 KW – 260 KW me këto karakteristika;

- Tensioni i punes (elektrik)	380V - 400V
- fuqia motorike	1100W
- Rendimenti	55%- 87 %
- Presioni i ujit	1,5-3,8 bar
- Lartësia	2450 mm
- Gjatësia	2000 mm
- Gjerësia	1520 mm
- Pesha	1500 -1700 kg
- kapaciteti ditor i silozit	1m3 - 1.5 m3

Operatorët ekonomik mund të ofrojnë edhe kaldaja me dimensione të ngjashme sipas përcaktimeve të mësipërme, në parametrat teknike të kërkuara, me qëllim funksionimin e këtyre pajisjeve teknike normalisht për ngrohjen e vazhdueshme të ambjeteve të spitalit.

IV. 1 silloz metalik me kapacitet 10 -20 ton.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjen teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.3. Ofertuesi duhet te paraqese per kaldajat e siperpermendura:

-certifikate konformiteti te vlefshme e leshuar nga shoqeriae licensuar nge MIE, per kete qellim duhen te paraqiten certifikatat e konformitetit te seciles kaldaje dhe Akt-miratimet perkatese te shoqerise qe ka leshuar keto certifikata konformiteti.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar duke u bazuar në piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Si dhe ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ I vlerësimit të konformitetit, ia kredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

2.3.4. Paisjet teknike (djegesi, kaldajat dhe sillozi) duhet te jene ne pronesi te operatorit ekonomik ofertues ose ne kontrata qeraje noteriale.

Per paisjet teknike ne pronesi per te vertetuar kete, operatori ekonomik duhet te paraqese akt çdoganimi ose e pasqyruar ne Bilanc ose me fature blerje.

Per paisjet teknike te marra me qera duhet te paraqitet kontrata qeraje noteriale e shoqeruar me dokumentet e pronesise se qeradhenesit. Kontratat noteriale te qerase duhet te jene te vlefshme ne ditën e hapjes se ofertave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjen teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.5. Ofertuesi duhet te paraqese: Nje deklarate nga ana e tij ku:

- te marre persiper me shpenzimet e veta te beje montimin e kaldajave/ pajisjeve teknike te kerkuara sipas specifikimeve te mesiperme te percaktuara menjehere pas marrjes se njoftimit nga Autoriteti Kontraktor,
- kryerjen e cdo riparimi gjate kohes se punes se kaldajes brenda afateve te kontrates se lidhur.

***Shënim: Kriteri konsiderohet i permbushur ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjen teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese:

a) Operatori ekonomik ofertues ne rastet **kur eshte prodhues** i lendes djegese biomase Pelet Druri objekt prokurimi duhet te paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent; **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” ose ekuivalente.

b) Operatori ekonomik ofertues ne rastet **kur nuk eshte prodhues** duhet te paraqese kontrate furnizimi noteriale me prodhues te lendes djegese biomase pelet ose me distributor te autorizuar nga prodhuesi i lendes djegese biomase pelet, **shoqeruar me certifikatat në emer te prodhuesit: ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente** në përputhje me objektin e prokurimit; **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” ose ekuivalente** në përputhje me objektin e prokurimit i lendes djegese biomase Pelet Druri objekt prokurimi, Ose **duhet te paraqese autodeklarate** qe furnizuesi nga i cili merr lenden djegese biomase Pelet Druri objekt prokurimi duhet te kete çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent; **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” ose ekuivalente.

Ne vetdeklarim te pershkruhet edhe: (rezervoj te drejten per verifikimin e vetdeklarimit ne procesin e vleresimit).

C) Operatori ekonomike per nevojat e montimit te kaldajve dhe riparimit te tyre gjate zbatimit te kontrates; Duhet te disponoj certifikaten EN ISO 3834-2: 2006(per saldimet) ose ekuivalent, **OSE** te paraqes kontrate bashkepunimi me subjekt te specializuar / pajisur me certifikaten EN ISO 3834-2: 2006 (per saldimet)ose ekuivalent.

Çertifikatat duhet te jene te vlefshme ne ditën e hapjes se ofertes dhe te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga RSH.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zërave të punëve/ mallrave/ shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas kontratës së bashkëpunimit.

***Shënim: Kriteri konsiderohet i permbushur ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79/1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1,3,4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në

fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se se mallrat, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertues vetë paraqesin çertifikata të lëshuara ne perputhje me objektin e prokurimit nga një organ I vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar I akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për cilësinë e produkteve që do të furnizojne dhe garancinë e tyre sipas normativave standarte si dhe perdorimi i lendes ngrohese ne sigurim te bio energjise per te shmangur efektin Sere ,te ngrohjes globale dhe te minimizimit te emetimit te gazeve sere ne atmosfere ne funksion te sistemit te menaxhimit te ambjenti

-
- *ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime me të ulta.*

ISO 9001:2015 perfaqeson standartin nderkombetar unanim i njohur si standarti qe i perket kerkesave per nje sistem manaxhimi te cilesise. Ky standart aplikohet per cdo shoqeri pavaresisht madhesise ose fushes se aktivitetit.

- *ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.*

-Certifikata standarde Iso 3834 është një sistem i krijuar nga ISO në mënyrë që të specifikojë kushtet e përshtatshme të cilësisë bazuar në metodat e ndërmarrjeve prodhuese të saldimit, të cilat janë burimi i shkrirjes në materialet metalike, dhe për të siguruar praktikën e duhura të prodhimit dhe prodhimin cilësor. Certifikata Iso 3834 Ky dokument, i cili përcakton aftësinë e saldimit të prodhuesit i cili kryen punën e prodhimit në punët e prodhuara në fabrikë ose në terren, tregon cilësinë dhe ekspertizën e prodhuesit.

- *Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e mallit duke patur parasysh se furnizimi i kërkuar është tepër sensitiv dhe ka impakt në mjedis.*

Gjithashtu te gjitha certifikatat ISO te sipercituara jane vendosur konform 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar nen titullin “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” pika 1 ku percaktohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

2.3.7. Ofertuesi duhet te paraqese nje deklarate nga ana e tij ku te marre persiper se gjate gjithe periudhes se kesaj MK-je furnizimi me lenden ngrohese Pelet Druri do te jete ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara si ne shtojcen 6 te kesaj DST-je.

***Shënim: Kriteri konsiderohet i permbushur ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion lenda ngrohese Pelet Druri për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.8.OE deri ne **afatin e fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave** te paraqesi fizikisht mostren e mallit Pelet sipas specifikimeve te kerkuara ne shtojcen 6 te kesaj DST-je shoqeruar me nje shkrese percjellese te firmosur, vulosur e cila te dorezohet nga Administratori ose nje person I pajisur prej tij me Autorizim shoqeruar me mjet identifikimi (karte identiteti/pasaporte Biometrike) prane zyres se protokoll - arshives.

Fleteanaliza e Mostres se mallit Pelet me date leshimi jo me vone se 90 dite nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates te dergohet ne rruge elektronike ne SPE.

Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane Sekretarise Zyres se protokoll-Arshives, Qendra Spitalore Rajonale Berat, te mbyllura ne nje kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

-“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « » dhe jo para afatit te hapjes se ofertave 21/08/2025.

Sqarim per kriteret e mesiperme: Autoriteti Kontraktor Qendra Spitalore Rajonale Berat I perfshire ne projektin e Ministrise se Mjedisit dhe te Ministrise se Shendetesise per zhvillimin e teknologjive novative , bio energjise per te shmangur efektin Sere te ngrohjes globale dhe te minimizimit te emetimit te gazeve sere ne atmosfere nuk zoteron kaldaja bioenergjise ne pronesi.

Operatori fitues ne kete procedure duhet te instaloj vete keto aggregate. Sqarojme se pikat 2.3.4/2.3.5, jane te rendesishme si kriteret vleresimi menjehere pas shpalljes fitues OE duhet ti montoj vete kaldajat e siperpermendura pasi AK-ja nuk disponon kaldaja te teknologjise se BIO-ENERGJISE.

Argumentimi: Në bazë të nenit 40 pika 6/a,b,c te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Në përputhje me nenin 40, pika 6 a) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u

kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

2.3.9. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimeve dhe vendosjen mirmbajtjen ne gjendje pune te paisjeve teknike te kerkuara instaluara objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punetore prej minimalisht 4 (kater) punonjes:

Numri i përcaktuar i punonjësve te kerkuar me siper argumentohet si më poshtë:

Kaldaist	1 (nje)
Punonjes	1 (dy)
Elektracist	1 (nje)
Mekanik.	1(nje)

Per te vertetuar duhet te paraqiten dokumentacionin si me poshte:

Per permbushjen e ketij kriteri kerkohet listpagesa E-Sig. 0.25 per muajin e fundit: qershor 2025

Per Kaldaistin, elektracist dhe mekanik te paraqitet kontrate pune te vlefshme ne ditën e hapjes se ofertave si dhe Deshmi aftesie /certifikaten trajnimit/deshmi te formimit profesional si dhe ekuivalentet e ketyre certifikimeve leshuar nga autoritetet te autorizuar/certifikuara per dhenine e tyre .

***Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kerkohet plotesimi i ketij kriteri ne perputhje me specifikën teknike te objektit qe prokurohet.

2.3.10. Operatori ekonomik ofertues për të garantuar cilësinë e punës gjatë shërbimit duhet të ketë të punësuar:

Inxhinier Mekanik 1 (nje) i cili duhet të ketë kontratë pune noteriale aktive në ditën e hapjes së ofertave.

Te paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

-Kontrate pune

-Diplome

***Shënim: Kriteri konsiderohet i permbushur në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij Inxhinier Mekanik është vendosur në funksion të realizimit të objektit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit lidhur me Instalimin, funksionimin dhe mbarevajtjen e sistemit të paisjeve teknike bazuar në specifikën e këtij shërbimi.

Bazuar në pikën 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 2, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, AK kërkon 1 (një) Inxhinier Mekanik kjo në përputhje me natyrën e kontratës, në funksion të realizimit të objektit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit lidhur me Instalimin, funksionimin dhe mbarevajtjen e sistemit të paisjeve teknike bazuar në specifikën e këtij shërbimi pasi AK nuk ka në strukturën e burimeve njerezore Inxhinier Mekanik. Ky kriter me kërkesën për 1 (një) Inxhinier Mekanik në këtë numer minimalist është vendosur dhe në përputhje me përmasën e kontratës.

AK me plotësimin e këtij kriteri në vazhdimësi gjatë periudhës së zbatimit të kontratës garanton zgjidhjen në mënyrë profesionale dhe të shpejtë të avarive në paisjet teknike të instaluar duke garantuar vazhdueshmërinë e këtij shërbimi.

AK kërkon plotësimin e këtij kriteri bazuar në tipologjinë e objektit të kontratës.

2.3.11.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë

te pakten 1(nje) kamion me vinç me nje kapacitet ngarkese te Mallit Pelet jo me pak se 10 ton, ne pronesi ose me kontrate qeraje .

Per te vertetuar kete OE ofertues duhet te paraqese si me poshte:

- *Leja e Qarkullimit.*
- *Polica e Sigurimit te detyrueshem te mjeteve motorrike.*
- *Kontrolli Teknik Vjetor – akt kolaudimin.*
- *Raport Inspektimi teknik per paisjen e vinçit te vlefshme e leshuar nga shoqeri te licensuar.*
- *Per mjetin e siperpermendur ne rast se eshte marre me kontrate noteriale qeraje OE duhet te kete kontraten e qerese aktive ne ditën e hapjes se ofertave te shoqeruar me aktin e pronesise ne emer te qiradhenesit si dhe dokumentacionin e siper kerkuar te vlefshem.*

***Shënim: Kriteri konsiderohet i permbushur ne fazen e ofertimit te operatoreve ekonomik me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjeti për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Per sa i perket kapacitetit te ngarkeses se automjetit jo me te vogel se 10 ton argumentohet: Pasi kapaciteti mbajtes i sillosit e kemi kerkuar nga 10-20 ton AK per te mos diskriminuar OE kerkon permbushjen e ketij kriteri.

Automjet 10 tonesh eshte i pershtatshem si per manovrimin e furnizimit ne pozicionin e vendosjes se sillosit si dhe me kapacitetin e kerkuar te sillosit.

AK ka vendosur plotesimin e ketij kriteri me kete kapacitet nisur edhe nga konsumi ditor i

llogaritur minimalisht ne kushte normale temperature dimerore cka do ti jepte paleve kohe te mjaftueshme per furnizimet e njepasnjeshme duke qene se sherbimi i

ngrohjes eshte nje sherbim i rendesise se vecante per nje Institucion Spitalor.

Plotesimi i ketij kriteri ne zbatim te nenit 3 te LPP-se nuk ngushton konkurencen pasi AK per

plotesimin e ketij kriteri nuk ka percaktuar kapacitet fiks dhe ka dhene alternativat:për

realizimin e kontratës, duhet të disponojë ne pronesi ose me kontrate qeraje te pakten 1(nje) kamion me vinç me nje kapacitet ngarkese te Mallit Pelet jo me pak se 10 ton .

Per mjetin e siperpermendur te marre me kontrate noteriale qeraje OE duhet te kete kontraten e qerase aktive ne ditën e hapjes se ofertave te shoqeruar me aktin e pronesise ne emer te qiradhenesit si dhe dokumentacionin e siper kerkuar te vlefshem.

Nisur nga sasia e parashikuar per kete MK, sasine e pritshme ditore ne kushte normale,

kapacitetin e sillosit me kapacitet 10-20 ton ku do te garantohet sasia e pritshme per nje

periudhe 10-20 ditore, AK argumenton:-sigurimin ne vazhdimesi te sherbimit duke i paraprire garantimit te furnizimit me lenden ngrohese pelet ne sasite e pritshme te konsumit disa ditor duke marre ne konsiderate kushtet atmosferike, ditet e pushimi/ festa zyrtare te cilat mund te rrezikojne furnizimet.

-vjen ne ndihme te OE per perllogaritjen e cmimit, kosmos duke marre ne dispozicion nje Kamion

me vinc me kapacitet ngarkese ne funksion te parametrave te paisjeve teknike te kerkuara per

realizimin e ketij sherbimit duke shmangur transporte te shpeshta te cilat mund te rrezikojne

vazhdueshmerine e sherbimit te ngrohjes si dhe do te derivonte ne rritje te kostove.

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në kërkesën e miratuar “Furnizim me lëndë ngrohëse Pelet Druri për shërbimin e ngrohjes” me Nr.3748 Prot., e dates 10/07/2025, si dhe bazuar në eksperiencën e viteve dhe për të garantuar shërbimin e ngrohjes të ambienteve të QSRB,

Ky prokurim ka për qëllim sigurimin e shërbimit të ngrohjes së ambienteve të institucionit gjatë sezonit të ftohtë, përmes blerjes së lëndës djegëse (pelet) dhe

vënies në dispozicion me qira të kaldajave funksionale, Nevoja për këtë shërbim buron nga: .

Mungesa e një sistemi të përhershëm të ngrohjes me eficiencë të lartë në ambientet e institucionit. . Sigurimi i kushteve të përshtatshme të temperaturës në hapësirat e brendshme për pacientët, personelin dhe vizitorët, në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe kërkesat ligjore. .

Sigurimi i një zgjidhjeje fleksibël dhe me efikasitet të lartë energjetik, duke përdorur kaldaja të reja ose të mirëmbajtura mirë dhe karburant ekologjik (biomasa pelet), i cili ka ndikim më të ulët në mjedis.

specifikimet teknike të lëndës ngrohëse pelet dhe të pajisjeve teknike për këtë shërbim për periudhën 15.11.2025 - 31.12.2025 (46 ditë), 01.01.2026 – 15.03.2026 (74 ditë), 15.11.2026 – 31.12.2026 (46 ditë), pra gjithsej 166 ditë janë si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia e pritshme
1	Furnizim me lëndë ngrohëse Pelet druri	Kg	124,500
2	Kaldajat me qera	Ditë	166

Specifikimet teknike të lëndës ngrohëse – Pelet, si më poshtë:

1. Fuqia kalorifike 4 .2 – 4.5 kw/kg
2. Lagështira 8.5 – 9.5 %
3. Mbetja e hirit 0.01 – 0.02 %/ kg
4. Dimensionet 30 – 40 mm
5. Gjatësia 6 – 8 mm
6. Sasia e squfurit që çlirohet gjatë djegies 0.0025 – 0.003 %
7. Diametri 6 mm

Furnizimi do të kryhet me thasë me kamion me vinç i cili do ti shkarkojë thasët me Pelet në sillosin e kaldajës.

Specifikimet teknike të pajisjeve teknike, si më poshtë:

I. 1 (një) djegës (brucator) me pelet me këto karakteristika;

- fuqia min/max në kë 400-500KW*
- tensioni i punës 220 v -240 v*

- fuqia e motorit të ventilatorit 190w
- kandela e ndezjes 750w
- Dimensionet 360x420x1200mm
- Shneku $\Phi 110mm$
- fuqia motorit të shnekut 180w
- dimensioni i tubit të shkarkimit 75 mm
- pesha 80 -100 kg

II. 1 (një) kaldajë me Pelet, me fuqi 480-500 kw me keto karakteristika;

- tensioni i punes **380V- 400V**
- fuqia motorike 1100W
- rendimenti 55%-87%
- presioni i ujit 1.5-3.8 bar
- lartësia x gjatësia x gjerësia 2750x2180x1720 mm
- pesha 1750 – 1900 kg
- kapaciteti ditor i sillozit **1.5m³-2m³**

III. 1 (një) kaldajë me Pelet, me fuqi 220 KW – 260 KW me këto karakteristika;

- Tensioni i punes (elektrik) **380V - 400V**
- fuqia motorike 1100W
- Rendimenti 55%- 87 %
- Presioni i ujit 1,5-3,8 bar
- Lartësia 2450 mm
- Gjatësia 2000 mm
- Gjerësia 1520 mm
- Pesha 1500 -1700 kg
- kapaciteti ditor i silozit **1m³ - 1.5 m³**

Operatorët ekonomik mund të ofrojnë edhe kaldaja me dimensione të ngjashme sipas përcaktimeve të mësipërme, **në parametrat teknike të kërkuara**, me qëllim funksionimin e këtyre pajisjeve teknike normalisht për ngrohjen e vazhdueshme të ambjeteve të spitalit.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Objekti I prokurimit: “Furnizim me lëndë ngrohëse Pelet druri për shërbimin e ngrohjes”- Marrëveshje Kuadër me një operator të vetëm ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 14 (katërmbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia e pritshme
1	Furnizim me lëndë ngrohëse Pelet druri	Kg	124,500
2	Kaldajat me qera	Ditë	166

§ Qëllimi i shërbimit: Me qëllim që të krijohen kushte optimale jetese për periudhën e dimrit, për pacientët dhe personelin e QSRB.

§ Detyrat: Shërbim ngrohje, të gjithë ambienteve të kërkuara nga AK.

§ Shpërndarja: Shërbim ngrohje, të gjithë ambienteve të kërkuara nga AK.

§ Periudha e realizimit të kontratave do të jetë nga 15.11 2025 - 31.12.2025, 01.01.2026 – 15.03.2026, 15.11.2026 – 31.12.2026, pra gjithsej 166 ditë.

§ Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Në ambientet e Qendrës Spitalore Rajonale Berat.

Operatori do të realizojë çdo riparimi gjatë kohës së punës së kaldajës brenda afateve të kontratës së lidhur.

Afatet e lëvrimit:

Kontratat do të jepen brenda periudhës: Nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuader me OE të shpallur fitues , me afat perfundimtar 14 muaj nga data e nënshkrimit të MK-se.

Qendra Spitalore Rajonale Berat do të lidhë kontratë në bazë të nevojave të saj.

Autoriteti Kontraktor mund të lidhin kontratë për çdo nevojë që del e paparashikuar dhe është e domosdoshme në çdo kohë.

Afati i lëvrimit të mallit do të jetë sipas kërkesave të Qendres Spitalore Rajonale Berat.

Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialit detyrues sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave.

Argumentim: Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion kerkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT

Armano PEPA

Elona DUNDO

Adriano BEQOLLARI

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ARBEN KONOMI